

Environmental issues between the government and the opposition, business and civil society

Denisa Xhoga*

Environmental issues often create debate between government and opposition, civil society and industrial businesses. Between these four players stand as a referee the media. In this area the public relations of the government and opposition are clear, as well as are distinguished new forms of interaction between information with marketing and public relations. The biggest debates have begun with the request of businesses, for example, to build near the artificial lake, the importation of waste from Europe, with the government request for the import of chemical weapons, the establishment of Hydropower's in Valbona and elsewhere, debate that open and reopen occasionally trying to find a social field for approval.

Scenarios are always the same: the business; the industrial actors promote the political force that is in rule, to take legislative initiatives. These are made public through the media, which publishes the smell that is creating an absorbing debate audience. Media of all shapes, classic, off-line and on-line become the arena of "war". According to media Couldry contains the keys to go to the authorities. According to him, media "the symbolic power" carries a broad impact on society more prominent than other forms of power, such as economic power. Following the publication of the initiative government media rises civil society, the examples of the past 5 years have shown how "civil society", but ordinary citizens are organizing protests through calls made "on line", by civil society actors. Online media, social networks and blogs have served as a means of protest action organization, supported and in some cases even promoted by the opposition. "This is the dynamics of mass communication" by Joseph Dominic explained. According to Tocqueville social thinkers have highlighted the

* Denisa Xhoga, PhD Candidate, University of Tirana. Email: dxhoga@yahoo.com

complex balance of good and evil, social, accompanied by powerful media institutions.

Keywords: *Environment, Information, Marketing, Public Relation, Actors*

Çështjet e mjedisit mes qeverisë dhe opozitës, biznesit dhe shoqërisë civile

Abstrakt

Çështjet e mjedisit krijojnë shpesh debate mes qeverisë dhe opozitës, shoqërisë civile dhe bizneseve industriale. Në mes të këtyre 4 aktorëve si arbitër qëndrojnë mediat. Debatet më të mëdha kanë nisur me kërkesën e bizneseve, p.sh për të ndërtuar pranë Liqenit Artificial, për importimin e mbetjeve nga Evropa, me kërkesën qeveritare për importin e armëve kimike, etj. Debate që hapen dhe rihapen herë pas here me përpjekjen për të gjetur terren social për miratim. Skenarët janë gjithnjë të njëjta: biznesi dhe aktorët industrial e cëtojnë forcën politike në pushtet, që të ndër marrë iniciativa ligjore. Këto bëhen publike përmes mediave, të cilat i botojnë me nuhatjen që po krijojnë një debat dhe po thith audiencë. Mediat e të gjitha formave, klasike, offline dhe online bëhen arena e “luftës”. Pas publikimit në media të iniciativës qeveritare ngrihet shoqëria civile, shembujt e 5 viteve të fundit kanë treguar se si “shoqëria civile”, por dhe qytetarë të thjeshtë janë organizuar në protesta nëpërmjet thirrjeve të bëra online, nga aktorët e shoqërisë civile. Mediat online, rrjetet sociale dhe blogjet kanë shërbyer si mjete organizimi të aksionit të protestave, të përkrahura dhe në ndonjë rast edhe të nxitura nga opozita. “Kjo është dinamika e Komunikimit Masiv”, shpjeguar nga Joseph Dominic.

Fjalë kyçe: *Mjedis, informacion, marketing, marrëdhënie me publikun, aktorë*

Trajtesat mjedisore “të vonuara”

Në mediat shqiptare të pas viteve '90-të, artikujt në fushën e mjedisit kanë qenë të paktë dhe sporadikë. Ata rrallë herë dilnin në faqe të parë dhe shpesh konsideroheshin nga redaktorët si artikuj “mbushës” të faqes. Deri në vitin 2000 artikujt më të shumtë ishin mbi prerjet pa kriter të pyjeve, apo ndotjes që vinte nga industria e para viteve '90-të. Në shumë raste artikujt e mjedisit vinin nga shëndetësia, kështu përhapja e kolerës në Berat, që vinte nga ndotja e ujit, të shtruarit me silikozë që vinte nga puna në minierë, apo ndotja që vinte nga rafineria e naftës në Ballsh. Një tjetër temë mjedisore që vinte sërish nga shëndetësia ishte ndotja e ajrit. Matjet vinin nga Instituti i Shëndetit Publik dhe trajtimi i temës nga ana e gazetarëve bëhej në prizmin e dëmeve që sjell në shëndetin e njeriut dhe më pak trajtoheshin shkaktarët. Ndërsa artikujt mirëfilli mjedisor si: prerja e pyjeve nga vitet '90-të e deri vonë, gjuetia e paligjshme apo erozioni ngriheshin herë pas here si shqetësime, por pa shkaktuar debat.

Gjithçka ka ardhur vonë në këtë fushë. Ministria e Mjedisit u ngrit si institucion në vitin 2001, deri në atë kohë ekzistonte vetëm Agjencia Rajonale e Mjedisit dhe Pyjeve, krijuar më 1995, e cila shërbeu si bërthamë për krijimin e Ministrisë. Rrjedhimisht edhe politikat mjedisore janë të vonuara. Në Kushtetutë për herë të parë flitet për mjedisin në vitin '99, ku u përfshinë dy nene: 56, 59i.

Ndërkohë, zhvillimi i industrisë dhe sipërmarrjeve private nisi menjëherë pas viteve '90-të. Lejet e ndërtimit kanë nisur të jepen nga bashkitë e rretheve, që në vitin '91, ndërsa në 2008-tën është miratuar plani urbanistik për zonën e Liqenit Artificial, që e kthen nga zonë rekreacioni, në zonë urbanistike, ku lejohet dhënia e lejeve të ndërtimit. Ardhja e makinave të vjetra, të cilat

akuzohen si shkaktarët kryesorë të ndotjes së ajrit, kanë nisur të vijnë që në vitin '91. Industria e riciklimit e ka gjenezën e vet, që me krijimin e firmave të para të pastrimit të qyteteve, të krijuara po në vitin '91 dhe kulmojnë në vitin 2010. Gurorët, apo marrja e inerteve nga lumenjtë gjithashtu ka nisur menjëherë pas viteve '90.

Jo vetëm sipërmarrja private, por dhe shoqatat mjedisore ishin një hap përpara politikave shtetërore në drejtim të mjedisit. PPNE- Mbrojtja dhe Konservimi i Mjedisit Natyror në Shqipëri dhe ASPBM - Shoqata për Ruajtjen e Shpendëve dhe Gjitarëve, kanë ardhur në Shqipëri në vitin 1991, ndërsa REC - Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore në vitin 1993. Tashmë shoqëria civile në fushën e mjedisit është kthyer në një aktor të fuqishëm me ndikim në vendimmarrje. Por këta 4 aktorë nuk mund të qëndrojnë pa njëri-tjetrin. Mounier në librin "Personalizimi" shkruan: "Ekonomia nuk mund t'i zgjidhë përfundimisht problemet e saj vetëm në këndvështrimin e politikës, e cila ka për detyrë t'i formulojë ato sipas etikës"¹. Sipas Couldry mediat përmbajnë çelësat për të shkuar te pushtetet. Sipas tij, mediat "pushteti simbolik" ushtron një ndikim në shoqërinë e gjerë në mënyrë më të spikatur se trajtat e tjera të pushtetit, siç është pushteti ekonomik.

Ligjet e ardhura nga biznesi, iniciuar nga politika, kundërshtuar nga shoqëria civile dhe opozita

Mbi të ashtuquajturin "Ligji i mbetjeve" është shkruar në mediat shqiptare për herë të parë në vitin 2004, më pas në 2011 dhe së fundmi në shtator të këtij viti. Kjo ngjarje është fillesa e një mediumi të angazhuar. Emmanuel Mounier në librin

¹ Emmanuel Mounier, *Personalizimi*, Dita 2000, Tiranë, 2006, f. 113.

Personalizimi shkruan: “Forca krijuese e angazhimit lind nga kundërshtimi pjellor që ai nxit mes papërsosmërisë së shkakut dhe besnikërisë së tij absolute ndaj vlerave përkatëse” dhe më pas vazhdon me të qenit kritizues i situatës². Herën e parë, në vitin 2004, megjithëse çështja shkaktoi zemërim, “fitoi” mendimi i specialistëve³. Në vitin 2004, ish-Kryeministri Fatos Nano nënshkroi një marrëveshje mes Shqipërisë dhe Italisë për importin dhe riciklimin e plehrave. Kur drafti i marrëveshjes u bë publik, ai ngjalli kundërshtim të qytetarëve, shoqatave mjedisore dhe opozitës së kohës. Ata e akuzuan ish-Kryeministrin Nano se marrëveshja ishte bërë për të favorizuar një biznesmen italian që donte të ndërtonte në Shqipëri një impiant për përpunimin e plehrave të Italisë. Si rezultat, marrëveshja nuk u ratifikua asnjëherë në Kuvend dhe për këtë arsye mbeti e pavlefshme. Në këtë rast mediat online dhe rrjetet sociale ende nuk ishin aktive dhe si mjet komunikimi mes shoqërisë civile dhe qytetarëve për nisjen e protestave kanë shërbyer mediat klasike. Këtu shohim ndikimin e “udhëheqësve të opinionit publik në sensibilizimin e tij⁴.

Në vitin 2009-të, Qeveria Berisha nisi hartimin e një projektligji për importimin dhe riciklimin e mbetjeve. Partia Socialiste dhe shoqëria civile e kundërshtuan dhe protestuan kundër miratimit të tij në Kuvend. Kryeministri Edi Rama akuzoi ish-Kryeministrin Berisha se pas Ligjit të Importit fshiheshin lidhje mafioze dhe klienteliste të z. Berisha e ministrave të tij⁵. Në shtator të vitit 2011-të, pavarësisht

² Po aty, f. 119.

³ <https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2016/01/7-2004.pdf>.

⁴ Francis Balle, *Media dhe Shoqëria*, Papirus, Tiranë, 2011, f. 723.

⁵ Edi Rama, *Ligji i Plehrave antikombëtar, antinjerëzor, “Shekulli”*, 16.10.2011, Nr. 3478, f. 6.

kundërshtimeve, Ligji për Menaxhimin e Mbetjeve u votua në Kuvend me 76 vota pro. Dy muaj pas votimit, Presidenti Bamir Topi riktheu Ligjin për rishqyrtim në Kuvend, por shumica e rrëzoi dekretin e presidentit me 71 vota⁶. Në vitin 2011-të, një bashkim qytetarësh dhe shoqatash të shoqërisë civile të njohur si Aleanca kundër Importit të Plehrave (AKIP) mbledhi rreth 64 mijë firma për mbajtjen e referendumit kundër importit të mbetjeve. Firmat u dorëzuan në KQZ në mars të vitit 2012-të. Në këtë moment mediat klasike, ato online dhe rrjetet sociale shërbyen fuqishëm në nisjen e protestave të qytetarëve dhe në angazhimin e qytetarëve në referendum. Sikundër do të thoshte Nick Couldry te “Media, Shoqëria, Bota”, në këtë moment shohim gjithë mediat në aksion dhe shërbejnë si çelësa për të lëvizur pushtetet⁷. Në mars të 2013-ës, Gjykata Kushtetuese u shpreh pro mbajtjes së referendumit pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2013-të. Ndalimi i importit dhe riciklimit të plehrave u kthye në një nga premtimet kryesore të kreut të PS-së Edi Rama gjatë fushatës elektorale të vitit 2013-të. Me ardhjen në pushtet, vendimi i parë që mori qeveria Rama ishte miratimi i projektligjit për shfuqizimin e ligjit të vitit 2011-të. Në mars të 2016-ës, ministrja e Ekonomisë, Milva Ekonomi deklaroi se Qeveria po përgatitet të japë me koncesion importimin dhe riciklimin e plehrave. Asnjë detaj tjetër nuk u bë publik. Në korrik të 2016-ës, tre deputetë të shumicës, Eduart Shalsi, Ervin Bushati e Bujar Derveni propozuan në Kuvend një projektligj për importin e mbetjeve⁸. Sipas tyre, Projektligji i ri siguron që mbetjet që do të futen në Shqipëri nuk do të jenë të

⁶ Bamir Topi, *Pse rrëzova Ligjin e Plehrave*, Gazeta “Shekulli”, 3.09.2011, Nr. 3496, f. 3.

⁷ Nick Couldry, *Media, Shoqëria*, Instituti i Medias, Tiranë, 2011, f. 31.

⁸ <http://opinion.al/intervista-alarmi-nga-importi-i-mbetjeve-a-sjell-rrezik-projektligji-qe-votohet-te-enjten1-ne-parlament/>

rrezikshme⁹ dhe se vendi ka bërë përparime të dukshme në infrastrukturë dhe trajnimin e burimeve njerëzore. Në çdo rast, çdo deklaratë e shumicës shoqërohet me një shkrim me burim nga shoqëria civile¹⁰. Lëvizja Socialiste për Integrim propozoi që shoqëria civile të monitoronte zhdoganimin e mbetjeve për të qenë të sigurtë që mbetjet nuk do t'u përkasin kategorive të rrezikshme, pas dyshimeve të këtyre të fundit¹¹. Por, shoqëria civile nuk e pranon këtë rol¹². Pjesë e komunikimit intensiv ishte dhe "lufta e shifrave". Shumica u shpreh se industria e riciklimit po falimentonte, por gazetarët investigativë, pohuan të kundërtën¹³. Ligji u miratua me votat e shumicës dhe diskutimi i ligjit u shoqërua nga protesta dhe thirrje nga AKIP për mosvotimin e tij nga qytetarë dhe aktivistë shoqërorë. Ndërkohë edhe industria e ricikluesve krijoi shoqatë, por qytetarët ju bashkuan thirrjeve të AKIP, i cili i bën lajmërimet për protestë jo vetëm nëpërmjet mediave të shkruara dhe vizive, por dhe nëpërmjet faqes së saj në FB. Presidenti Nishani nuk e dekretoi ligjin, duke u shprehur kundër tij¹⁴. Mes kësaj lufte deklaratash dhe shifrash, servitur nga mediat, për qytetarët ka edhe

⁹ <http://www.oranews.tv/vendi/rama-doganat-instrumente-per-kontrolle-radioaktive/>

¹⁰ <http://www.javanews.al/analiza-perf.itimet-dhe-humbjet-e-shqiperise-nga-importi-i-mbetjeve/>

¹¹ <http://www.balkaninsight.com/al/article/importi-sekret-i-mbeturinave-i-alarmon-të-gjelbërit-e-Shqipërisë>

¹² [http://www.tiranaobserver.al/importi-i-mbetjeve-vasili-rol-monitorues-shoqerise-civile-por-ja-si-i-pergjigjet-aktivisti-arlind-kote/;](http://www.tiranaobserver.al/importi-i-mbetjeve-vasili-rol-monitorues-shoqerise-civile-por-ja-si-i-pergjigjet-aktivisti-arlind-kote/)

¹³ <http://www.bletashqiptare.com/ekonomi/mashtrimi-me-plehrat-industria-e-riciklimit-me-rritje/>

¹⁴ <http://www.channel-one.al/importi-i-mbetjeve-nishani-nuk-do-te-zhgenjen-interesin-qytetar/>

këndvështrime të tjera¹⁵. Duhet thënë se, pikërisht dështimi i këtij ligji më 2011, bëri që shumica e sotme të nxjerrë një mësim. Në agjendën e ardhshme të institucioneve shqiptare, në momentin e shqyrtimit të një drafti ligjor të zhvillohen dëgjesa publike me aktorët, që zakonisht janë shoqëria civile dhe komuniteti. Në vitin 2016, drafti erdhi pa u diskutuar me një nga aktorët kryesorë, shoqërinë civile dhe përsëri dështoi. Ajo çfarë vihet re është se reagimet qytetare në rrjetet sociale, roli i qytetarit-gazetar, nuk e ulin rolin e mediave klasike, por e kanë forcuar atë, e cila edhe vetë nuk është më klasike, pasi ato tashmë gjenden edhe online. Ato tashmë “shiten” dy herë, një herë gazetat te blerësit, apo TV-të tek audienca dhe herën e dytë me anë “të klikimeve” në faqet e tyre të Webit, apo llogarive të hapura në rrjetet sociale. Pra, me shtimin e qytetarit-gazetar “pushteti i mediave” nuk është dobësuar, por është rritur konkurrenca mes vetë mediave.

Kërkesa qeveritare për armët kimike

Gazeta franceze Le Monde¹⁶ shkruan se Washingtoni po nxit Shqipërinë të pranojë propozimin për shkatërrimin e armëve kimike të Sirisë dhe se Tirana zyrtare po e shikon me kujdes propozimin e bërë javën e kaluar nga Washingtoni, por nuk jepen detaje lidhur me këtë çështje. Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, konfirmoi¹⁷se, Sekretari amerikan i Shtetit John Kerry, i telefonoi Kryeministrit Edi Rama lidhur

¹⁵ <http://www.mapo.al/2016/09/importi-i-mbetjeve-rrezik-real-apo-populizem/>

¹⁶ http://www.lemonde.fr/europe/article/2013/11/04/les-etats-unis-sollicitent-l-albanie-pour-la-destruction-de-l-arsenal-nucleaire-syrien_3507912_3214.html?xtmc=albanie&xtcr=4

¹⁷ <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267206>

me çështjen e shkatërrimit të armëve kimike të Sirisë në Shqipëri. Ai u shpreh: “Nuk kemi një vendimmarrje, nuk kemi hyrë në çështje teknike dhe nuk ka nisur një proces konsultimi. Jemi në këtë fazë, nuk ka vend për alarm dhe nuk ka vend për të folur për legjislacion apo për konventa”. Ky ishte një lajm që erdhi nga mediat e huaja dhe opinionin publik shqiptar akuzoi Qeverinë e Shqipërisë për mungesë transparence. Gjithashtu, Qeveria akuzohet për kontradiksion, pasi një muaj më parë miratoi Ligjin Kundër Importit të Mbetjeve Kimike, ndërsa tani po merr parasysh propozimin për importin dhe shkatërrimin e armëve kimike siriane¹⁸. Ndërkohë, gjithmonë e më tepër përflitet në media se Uzina e Lëndëve Plasëse në Mjekës është vendi ku mund të përfundojnë për t’u trajtuar armët kimike siriane¹⁹. Eksperti i toksikologjisë Dr. Qemal Poçi në një intervistë shprehet kategorikisht kundër shkatërrimit të armëve kimike të Sirisë jo vetëm sepse “nuk i kemi kapacitetet e nevojshme logjistike për ta bërë këtë, por na mungojnë edhe specialistët përkatës²⁰”. Gjithashtu, ai deklaroi se armët kimike të Shqipërisë të cilat u shkatërruan në vitin 2007 nuk ishin të fortësisë së armëve kimike të Sirisë. Grupet ambientaliste shqiptare përfshirë edhe Aleancën Kundër Importit të Plehrave organizuan një manifestim përballë Kryeministrit kundër sjelljes në Shqipëri të armëve kimike siriane.²¹ Deri më tani protesta më masive është ajo e organizuar më 12 nëntor 2013,

18

https://www.youtube.com/watch?v=Dv0xPp5ivëY&feature=youtu.be_gdata

19 <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267239>

20 <http://www.gazetadita.al/armet-kimike-te-sirise-ne-shqiperi-kemi-cerek-shekulli-pa-sherbim-kimik/>

21 <http://www.reuters.com/article/syria-crisis-albania-idUSL5N0IX3CV20131112>

e cila u zhvillua përballë Kryeministrisë dhe Ambasadës Amerikane. Protestuesit si rrallë herë kanë dalë me thirrje kundër propozimit të Shteteve të Bashkuara për të shkatërruar armët kimike në Shqipëri. Në rrjetet sociale është bërë solidarizim me këtë çështje dhe është duke u plotësuar edhe një peticion online kundër ardhjes së armëve kimike siriane në Shqipëri²².

Nuk munguan as reagimet nga mediat e vendeve fqinje, të cilat rrezikoheshin nga ndotja e shkaktuar nga lëndët kimike në Shqipëri. E përditshmja greke "Kathimerini"²³ shkruan se lajmi i shkatërrimit të armëve kimike siriane në Shqipëri ka alarmuar Qeverinë Greke, e cila mendon se ekziston një rrezik mjedisor për të gjithë rajonin, sidomos nëse planifikohet zhvillimi i operacionit në jug të vendit, pranë kufirit me Greqinë. Artikulli bën thirrje për krijimin e një fronti të përbashkët të vendeve fqinje të Shqipërisë, për t'i mbushur mendjen Tiranës të mos pranojë, edhe pse stimujt financiarë të perëndimit mund të jenë të mëdha. Edhe në Prishtinë u organizuan protesta. Në gazetën "Express" u publikua një anketë, nëse do ta vizitonin kosovarët bregdetin e Shqipërisë pas ardhjes së armëve kimike, dhe shumica u shpreh Jo²⁴. Opinioni publik në Maqedoni u shpreh i shqetësuar për rrezikun e mundshëm gjatë shkatërrimit të armëve kimike dhe gazit, mbetjet e të cilave për shkak të afërsisë mund të përhapen falë erës.

²²https://www.avaaz.org/en/petition/Peticion_kunder_pranimite_t_e_armeve_kimike_te_Sirise_nga_Shqiperia_No_to_Assad_Chemical_Weapons_in_Albania/?f.bss

²³ <http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267494>

²⁴ http://www.gazetaexpress.com/arkiva/anket-235-turist-235-t-nga-kosova-nuk-do-ta-vizitonin-bregdetin-shqiptar-n-235-se-aty-shkat-235-rrohen-arm-235-t-kimike-siriane-126299/?arch_tb=temp

Kërkesa për ndërtim në Parkun e Liqenit Artificial

Më qershor 2012 nisi prerja e pemëve për zgjerimin e rrugës së Elbasanit. Shqetësimin për herë të parë e ngrenë mediat, vazhdoi nga shoqëria civile²⁵, u amplifikua nga prononcimet e politikës²⁶, opozitës dhe vazhdoi po me protestat e shoqërisë civile, mbështetur nga opozita. Problematika që u ngrit ishte mungesa e dokumentacionit dhe e mendimit të ekspertëve, për dëmin që i vinte mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. U bënë disa emisione dhe shkrime në gazeta dhe nisën protestat e shoqërisë civile²⁷. Bashkia e Tiranës drejtohej nga Lulzim Basha, megjithatë lufta duket se ishte më tepër politike dhe i shërbente më tepër asaj se dobisë së qytetarëve.²⁸. Lufta për të ndërtuar përreth Liqenit Artificial është e hershme dhe ka shkaktuar disa herë debate mes pozitës dhe opozitës, një herë kur këto forca kanë qenë në pushtet dhe një herë tjetër kur kanë qenë në karrige. Debati i hapur për ndërtimet te Diga e Liqenit, ka ardhur dhe riardhur disa herë në media, ndryshon vetëm emërtimi i aktorëve. Të parin projekt konkret për betonizimin e Liqenit Artificial e bëri më 2008 Edi Rama, atëherë kryetar Bashkie i Tiranës. Me një juri ndërkombëtare ish-Kryebashkiaku Rama miratoi Projektin për Ndërtimet të Larta në këtë zonë. Në atë kohë, Ilir Meta denoncoi projektin duke thënë se aleanca mes Ramës dhe

²⁵ Sazan Guri, *U prenë 100 pemë*, Gazeta Shqiptare, 5.06.2012, Nr. 5672, f. 11.

²⁶ Magdalena Alla, *Prerja e pemëve vijon në mënyrë barbare. Edi Rama komenton prerjen e pemëve në Rrugën e Elbasanit*, Gazeta Shekulli, 23.06.2012, Nr. 3485, f. 3.

²⁷ Artan Lame, *Pemët, çështje brezash: Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, protestojnë ambientalistët*, Shqiptarja.com, 3.07.2012, Nr.155, fq. 1,4.

²⁸ Artur Zheji - *Përse sulmohet Lulzim Basha!*, Mapo 9.07.2012, Nr. 621, f.11.

Berishës po prishte mjediset publike. Këtu shohim atë që Couldry thotë: “Natyrat dalluese të pushtetit të mediave”: ‘mediat si të tilla nuk ka fuqi, por ajo përfshin fjalët nja, prej të cilave pushteti sot operon’²⁹. Pra, mediat krijojnë pushtet, pasi është rruga që të çon te pushtetet.

Edi Rama kryetar Bashkie iu kundërpërgjigj tre ditë më vonë Ilir Metës në një intervistë te “Panorama”: “...mllefi dhe ambicia e shfrenuar për pushtet personal e klanor po e çojnë Ilir Metën drejt një rruge ndarëse të vjetër, konfliktuale e pa të ardhme”. Por këtij projekti të Ramës i kishte paraprirë dy vite më herët një vendim i KKKRRTRSH-së. Kryeministri i atëhershëm Sali Berisha firmosi në nëntor 2006 ndryshimin e destinacionit të kësaj zone, nga zonë sportive në zonë ndërtimi. Ndërkohë një nga zv. ministrat e tij, Florian Mima 4 vjet më vonë shkruan: “Rama po betonizon e po ua jep ndërtimin njerëzve të vet. Ne deputetët e qarkut të Tiranës, i bëjmë thirrje kryeministrit të ndalojë ndërtimet”³⁰. Pak javë më vonë Berisha përforcoi të njëjtat akuza, duke i vënë Kryebashkiakut Rama epitelin Mr. i 20%-shit, që u përdor si lajtmotiv i fushatës zgjedhore për Bashkinë e Tiranës. Vetë kandidati për Tiranën, Lulzim Basha premtoi se “sa të vinte në pushtet do të anulonte pallatet shumëkateshe te Liqeni”³¹. Historia përsëritet në gusht të 2014-tës në emër të shqetësimit se po betonizohet liqeni, socialistët akuzojnë Kryebashkiakun Basha se ka marrë rryshfet për të betonizuar liqenin, njëlloj si dikur demokratët akuzonin Ramën, atëherë Kryetar Bashkie.

Në fund të vitit 2012-të, PD e LSI bashkuan votat në Këshillin Bashkiak dhe miratuan Planin Urbanistik të Tiranës që

²⁹ Nick Couldry, *Media, Shoqëria*, Instituti i Medias, Tiranë, 2011, f. 121.

³⁰ <http://www.abcnews.al/lajme/aktualitet/2/45486>

³¹ <http://www.panorama.com.al/basha-do-anuloj-pallatet-shumekateshe-te-liqeni-artificial/>

parashihte ndërtime të larta edhe te Diga e Liqenit. Finalizimi i këtij vendimi u bë në ditët e para të gushtit 2014-të kur Lulzim Basha firmosi lejen e ndërtimit te Diga e Liqenit. Firma nisi punimet. Deri në atë moment shoqëria civile ka heshtur, duke ia lënë politikës fjalën. Por, nga ai moment nisin reagimet, të cilat çojnë deri në pezullimin e punimeve³². Krijohet aleanca “Qytetarët për Parkun” dhe hyn në lojë pushteti i tretë, Gjykata e Apelit i jep të drejtë Inspektoratit të Ndërtimit dhe rrëzon kërkesën e firmës, rrjedhimisht dhe lojën e politikës³³. “Një përdorim i tillë do të duket se kap forcën e pashmangshme që kanë mediat në politikën bashkëkohore, për të gjithë aktorët, në çfarëdo niveli qoftë të politikës, nga sfiduesit politikë lokalë dhe OJQ-të që ndërtojnë ndikimin e tyre nga jashtë sistemit formal partiak”, thotë Couldry mbi mediatizimin e politikës³⁴. Sipas Tocqueville mendimtarët socialë kanë nxjerrë në pah drejtpeshimin kompleks të së mirës dhe së keqes sociale, që shkon dhe shoqërohet me institucionet e fuqishme mediatike.

Konkluzione

Debatet në fushën e mjedisit janë të vetmet, që nuk fillojnë nga politika. Në këtë rast, politika është një prej aktorëve, sikundër është biznesi, shoqëria civile, apo institucionet. Ato mund të përdoren nga politika për qëllime të caktuara, por nuk nisin prej saj. Komunikimi mes aktorëve ka si kanal kryesor median, duke e kthyer dhe në një çelës për të arritur te pushteti, me qëllim ndryshimin e vendimmarrjes. Në momente të tilla debatesh,

³² <http://www.gazetadita.al/inuk-urdheron-nderprerjen-e-punimeve-te-diga-e-liqenit-artificial/>

³³ <http://www.civitas.al/al/kronika/pallati-te-liqeni-gjykata-pezuillon-lejen-e-ndertimit>

³⁴ Nick Couldry, *Media, Shoqëria*, Instituti i Medias, Tiranë, 2011, f. 121.

lajmet në fushën e mjedisit kthehen në lajme kryesore, headline, në ndonjë rast duke zbehur edhe lajmet e politikës, në disa raste të tjera kemi parë që janë kthyer dhe në lajme rajonale, apo ndërkombëtare. Gjithë qëllimi është që një çështje mjedisore të zgjojë edhe ndjeshmërinë e qytetarit më të thjeshtë dhe këtu hyjnë në aksion jo vetëm mediat klasike, por dhe ato online deri te rrjetet sociale. Në këto momente shohim media të angazhuara, shoqërinë civile në pararojë dhe qytetarët në protestë. Mediat nuk gjenden vetëm në rolin primar të saj, përçuese e informacionit, por kthehet dhe në një nxitëse aksioni. Ndërkohë, mediat si biznes arrin të realizojë shitjet maksimale, duke u shitur 4 herë, një herë si lajm te lexuesi dhe audienca, në rastet e televizionit, herën e dytë duke u shitur nëpërmjet reklamave dhe ndërkohë për të tretën herë i njëjti lajm shitet në mediat online të reklamuesit dhe për të katërtën herë nëpërmjet klikimeve, duke mbyllur kështu jo vetëm misionin mediatic, por dhe atë financiar.

Bibliografia

Alla, Magdalena. *Prerja e pemëve vijon në mënyrë barbare. Edi Rama komenton prerjen e pemëve në Rrugën e Elbasanit*. Gazeta Shekulli, 23.06.2012. Nr.3485.

Balle, Francis. *Media dhe Shoqëria*. Papyrus. Tiranë. 2011.

Couldry, Nik. *Media, Shoqëria, Bota*. Instituti i Medias. Tiranë. 2011. f. 121.

Couldry, Nik. *Media, Shoqëria, Bota*. Instituti i Medias. Tiranë. 2011.

Guri, Sazan. "Zgjerohet rruga e Elbasanit - Guri: U prenë 100 pemë". *Gazeta Shqiptare*. 5.06.2012. nr.5672. f.11.

Lame, Artan. *Pemët, çështje brezash. Zgjerimi i Rrugës së Elbasanit, protestojnë ambientalistët*. Shqiptarja.com. 3.07.2012. Nr. 155. f. 1,4.

Mounier, Emmanuel. *Personalizimi*. Dita 2000. Tiranë 2006.

Rama, Edi. *Ligji i Plehrave antikombëtar, antinjerëzor. "Shekulli"*. 16.10.2011. nr.3478. f. 6.

Topi, Bamir. *Pse rrëzova Ligjin e Plehrave*. Gazeta "Shekulli". 3.09.2011. Nr.3496. f. 3.

Zheji, Artur. *Përse sulmohet Lulzim Basha!* Mapo 9.07.2012. Nr.621. f. 11.

<http://www.opinion.al/intervista-alarimi-nga-importi-i-mbetjeve-a-sjell-rrezik-projektligji-qe-votohet-te-enjten1-ne-parlament/>

<http://www.oranews.tv/vendi/rama-doganat-instrumente-per-kontrolle-radioaktive/>

<http://www.javanews.al/analiza-perfitimet-dhe-humbjet-e-shqiperise-nga-importi-i-mbetjeve/>

<http://www.balkaninsight.com/al/article/importi-sekret-i-mbeturinae-i-alarmon-te-gjelbrit-e-shqiperise>

[http://www.tiranaobserver.al/importi-i-mbetjeve-vasili-rol-monitorues-shoqerise-civile-por-ja-si-i-pergjigjet-aktivisti-arlind-kote/;](http://www.tiranaobserver.al/importi-i-mbetjeve-vasili-rol-monitorues-shoqerise-civile-por-ja-si-i-pergjigjet-aktivisti-arlind-kote/)

<http://bletashqiptare.com/ekonomi/mashtrimi-me-plehrat-industria-e-riciklimit-me-rritje/>

<http://www.channel-one.al/importi-i-mbetjeve-nishani-nuk-do-te-zhgenjen-interesin-qytetar/>

<http://www.mapo.al/2016/09/importi-i-mbetjeve-rrezik-real-apo-populizem/>

http://www.lemonde.fr/europe/article/2013/11/04/les-etats-unis-sollicitent-l-albanie-pour-la-destruction-de-l-arsenal-nucleaire-syrien_3507912_3214.html?xtmc=albanie&xtcr=4

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267206>

https://www.youtube.com/ëatch?v=Dv0xPp5ivëY&feature=youtube_gdata

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267239>

<http://www.gazetadita.al/armet-kimike-te-sirise-ne-shqiperi-kemi-cerek-shekulli-pa-sherbim-kimik/>

<http://www.reuters.com/article/syria-crisis-albania-idUSL5N0IX3CV20131112>

https://www.avaaz.org/en/petition/Peticion_kunder_pranimit_te_armeve_kimike_te_Sirise_nga_Shqiperia_No_to_Assad_Chemical_Ëeapons_in_Albania/?fbss

<http://top-channel.tv/lajme/artikull.php?id=267494>

<https://www.parlament.al/wp-content/uploads/sites/4/2016/01/7-2004.pdf>

<http://eudo-citizenship.eu/NationalElectoralLaësDB/docs/kushtetuta-me-interpretime-te-gjk.pdf>

http://www.gazetaexpress.com/arkiva/anket-235-turist-235-t-nga-kosova-nuk-do-ta-vizitonin-bregdetin-shqiptar-n-235-se-aty-shkat-235-rrohen-arm-235-t-kimike-siriane-126299/?arch_tb=temp

<http://www.abcneës.al/lajme/aktualitet/2/45486>

<http://www.panorama.com.al/basha-do-anuloj-pallatet-shumekateshe-tek-liqeni-artificial/>

<http://www.gazetadita.al/inuk-urdheron-nderprerjen-e-punimeve-tek-diga-e-liqenit-artificial/>

<http://www.civitas.al/al/kronika/pallati-te-liqeni-gjykata-pezullon-lejen-e-ndertimit>